



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural / Direkcija za Poljoprivredu i Ruralni Razvoj /
Department of Agriculture and Rural development

09 nr. 58/ 2025

Data: 02.06.2025

Bazuar në nenin 2, të Rregullores MF -04/2017 "Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe vendimin e Kryetarit të Komunës 01. Nr, 378/025 të datës 26.05.2025, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, shpallë

Thirrje publike për OJQ

Për financim të projekt propozimeve të OJQ-ve,

- Organizimin e aktivitetit tradicional " Të Qethat 2025 "
- Organizimin e aktivitetit tradicional " Dita e Mollës 2025 "

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në kuadër të Komunës së Istogut u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e promovimit dhe organizimit të aktiviteteve tradicionale bujqësore, të aplikojnë për mbështetje financiare për organizimin e aktivitetit tradicional " Të Qethat 2025 " dhe aktivitetit "Dita e Mollës 2025 "

Qëllimi i kësaj shpallje publike është mbështetja dhe promovimi i aktiviteteve tradicionale siç është dita e qethjes së deleve dhe dita e vjeljes së mollës

Konkretisht, fondi i paraparë për organizimin e këtyre aktivitetit , shënimin e ditës tradicionale të të Qethave dhe Dita e vjeljes së Mollës do të përpiqet që përmes projekt propozimeve të organizatave joqeveritare të realizoj aktivitetin i cili ka të bëjë me promovimin e aktiviteteve tradicionale të komunitetit të blegtorëve dhe pemçtarëve.

Kjo ftesë për propozime është bërë në formë të shpalljes publike me qëllim që të gjitha organizatat e interesuara dhe të kualifikuara t'ju jepet mundësia dhe e drejta për paraqitjen e kërkesave të tyre për financim të projekt propozimeve. Për qëllimet e kësaj ftese për propozim, "organizatat" definohen si organizata kosovare joqeveritare, të bazuara në komunitet dhe/apo të bazuara në mirëbesim, si dhe në pjesëmarrje vullnetare.

OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet propozimet e tyre për fushat prioritare në vijim:

1. Organizimi i ditës së qethave të deleve "Të Qethat 2025";
2. Organizimi i aktivitetit "Dita e Mollës 2025 "

Përparësi kanë OJQ-të që kanë përvojë në organizimin e aktiviteteve të cekura

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 9,500.00 (nëntë mijë pesëqind) euro.

1. Organizimi i ditës së Qethave të deleve "Të Qethat 2025 ", vlera e planifikuar 6000.00 C

2. Organizimi i aktivitetit "Dita e Mollës 2025", vlera e planifikuar 3500.00

Afati i fondit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 29.06.2024.

Periodha e zbatimit të projekteve është maksimalisht për 120 ditë.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku 1 vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të kulturës, traditave dhe të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të bashkangjitur ne thirrje

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ndërtesa e komunës së Istogut, Rruga, Fadil Ferati, nr. 121 Istog, kati I, nr. 200.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: fadil.kabashit@rks-gov.net.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim ;

Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së

Certifikata e regjistrimit të OJQ-së- obligative

Certifikatën e numrit fiskal- obligative

Vërtetim nga ATK, që OJQ nuk ka obligime tatimore-obligative

Dëshmi e organizimit të aktiviteteve të ngjashme

F9 Formulari i aplikacionit për projekt.doc

F11 Forma e deklaratës për financimin e dyfishhtë.doc

F10 Formulari i propozim të buxhetit të projektit.xls





Direktorija për Bujqësi dhe Zhvillim Rural / Direkcija za Poljoprivredu i Ruralni Razvoj /
Department of Agriculture and Rural development

09, nr. 58/ 2025

Datum: 02.06.2025

Na osnovu člana 2. Uredbe MF-04/2017 „O kriterijima, standardima i procedurama javnog finansiranja nevladinih organizacija“, i odluke gradonačelnika opštine 01. br. 378/025 od 26.05.2025. godine, Direkcija za poljoprivredu i ruralni razvoj objavljuje

Javni poziv za NVO

Za finansiranje projektnih prijedloga nevladinih organizacija,

- Organizacija tradicionalne aktivnosti „Striženje ovaca 2025“

- Organizacija tradicionalne aktivnosti „Dani Jabuke 2025“

Direkcija za poljoprivredu i ruralni razvoj, u okviru opštine Istok, poziva sve nevladine organizacije registrovane u Republici Kosovo, čiji je program rada usmjeren na oblast promocije i organizacije tradicionalnih poljoprivrednih aktivnosti, da se prijave za finansijsku podršku za organizaciju tradicionalne aktivnosti „Striženje 2025“ i aktivnosti „Dan jabuke 2025“.

Svrha ovog javnog oglasa je podrška i promocija tradicionalnih aktivnosti kao što je dan striženje ovaca i dan berbe jabuka

Konkretno, fond predviđen za organizaciju ovih aktivnosti, proslavu tradicionalnog dana striženja i Dana berbe jabuka, nastojat će da kroz projektne prijedloge nevladinih organizacija realizuje aktivnosti vezane za promociju tradicionalnih aktivnosti zajednice stočara i voćara. Ovaj poziv za prijedloge se objavljuje u obliku javnog oglasa kako bi se svim zainteresovanim i kvalifikovanim organizacijama pružila prilika i pravo da podnesu svoje zahtjeve za finansiranje projektnih prijedloga. U svrhu ovog poziva za prijedloge, „organizacije“ se definišu kao kosovske nevladine organizacije, zasnovane na zajednici i/ili na povjerenju, kao i na dobrovoljnom učešću.

Nevladine organizacije u skladu s ovim javnim pozivom mogu aplicirati sa svojim projektnim prijedlozima za sljedeće prioritete oblasti:

1. Organizacija dana šišanja ovaca „Striženje 2025“;

2. Organizacija aktivnosti „Dan jabuke 2025“

Prednost imaju nevladine organizacije koje imaju iskustva u organizaciji gore navedenih aktivnosti.

Ukupna planirana vrijednost poziva je 9.500,00 (devet hiljada i petsto) eura.

1. Organizacija dana šišanja ovaca „Striženje 2025“, planirana vrijednost 6.000,00 €

2. Organizacija aktivnosti „Dan jabuke 2025“, planirana vrijednost 3.500,00 €

Rok za podnošenje prijedloga je 15 radnih dana i završava se 23.06.2024.

Period realizacije projekta je maksimalno 120 dana.

Pravo prijave sa svojim projektima imaju nevladine organizacije koje su registrovane u registru nevladinih organizacija u Republici Kosovo i koje djeluju u Republici Kosovo najmanje godinu dana prije datuma objavljivanja javnog poziva.

Nevladine organizacije koje se prijavljuju moraju dokazati da je njihov program rada usmjeren na oblast zaštite i promocije kulture, tradicije i prava i interesa zajednica na Kosovu.

Nevladine organizacije također moraju imati transparentno obavljane finansijske transakcije u skladu sa zakonodavstvom o nevladinim organizacijama u Republici Kosovo i u skladu sa računovodstvenim pravilima, kao i ispunjavati ugovorne obaveze prema pružaocu finansijske podrške i svim drugim pružiocima javne finansijske podrške.

Prije potpisivanja ugovora, nevladina organizacija mora dostaviti dokaz da odgovorna osoba u nevladinoj organizaciji i voditelj projekta nisu pod istragom za krivična djela, kao i dokaz da je nevladina organizacija riješila sva neriješena pitanja u vezi s plaćanjem neplaćenih doprinosa i poreza.

Prijedlozi se moraju dostaviti isključivo na dostavljenim obrascima, priloženim uz poziv.

Popunjena dokumentacija mora se poslati poštom ili lično, na sljedeću adresu: Direkcija za poljoprivredu i ruralni razvoj, Zgrada opštine Istok, Ulica Fadil Ferati, br. 121 Istok, , Prvi sprat, br. 200.

Proces prijema, otvaranja i pregleda prijava, ocjenjivanja prijava, ugovaranja, dodjele sredstava, vrijeme i način podnošenja žalbi, rukovanja dokumentima i indikativni kalendar realizacije poziva detaljno su opisani u Smjernicama za podnosiocima prijava javnog poziva.

Samo projekti koji su prihvaćeni u roku određenom ovim javnim pozivom, a koji u potpunosti ispunjavaju uslove navedene u javnom pozivu, bit će razmatrani za finansijsku podršku.

Sva pitanja u vezi s javnim pozivom mogu se razjasniti isključivo elektronskim putem, slanjem e-maila na adresu: fadil.kabashi@rks-gov.net.

Potrebna dokumentacija za prijavu;

Kopija lične karte ovlaštenog predstavnika NVO

Potvrda o registraciji NVO - obavezna

Potvrda o fiskalnom broju - obavezna

Potvrda od PAK-a da NVO nema poreske obaveze - obavezna

Dokaz o organizovanju sličnih aktivnosti

F9 Formular aplikacije za r projekt.doc

F11 Forma izjave o duplom financiranju.doc

F10 Formular prijedloga budžeta projekta.xls

